

ARGUMENTUM

news opinion analysis



**“Evropa e re në një
botë të re...”, Shqipëria
mikpret Komunitetin
Politik Evropian**

- HABEMUS PAPAM: Leo XIV
është Papa i zgjedhur për të
udhëhequr Kishën Katolike

- Partia Socialiste triumfon
në zgjedhjet 2025, siguron
mandatin e katërt me 83 mandate

- Evropë, faleminderit për asgjë!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpaket të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexuesve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 EDITORIAL

- “Evropa e re në një botë të re...”, Shqipëria mikpret Komitetin Politik Evropian.

05 FOKUS

- HABEMUS PAPAM: Leo XIV është Papa i zgjedhur për të udhëhequr Kishën Katolike.
- Zgjedhjet bëhen për të ofruar zgjidhje. 11 maji e humbi këtë shans,

09 OP/ED

- Evropë, faleminderit për asgjë!

11 REALPOLITIK

- Kështu po! Kuarteti i shpresës! Turp për Prishtinën! Samiti i Komitetit pa identitet!

14 POLITIKË

- Partia Socialiste triumfon në zgjedhjet 2025, siguron mandatin e katërt me 83 mandate.

15 JO VETEM LAJM

- Zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë konkurruese dhe të organizuara mirë, por munguan kushtet e barabarta të lojës, thonë vëzhguesit ndërkombëtarë.

- Dita e Dëshmorëve të Kombit/ Nderim për heronjtë që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë!

18 RETROSPEKTIVE DIPLOMATIKE

- 75 Vjetori i Deklaratës së Schumanit: Lindja e Bashkimit Evropian.

ENGLISH EDITION

21 ENGLISH TOP NEWS

- International leaders congratulate Prime Minister Rama after his victory in the parliamentary elections, securing a fourth term.

23 REALPOLITIK

- That's it! The quartet of hope! Shame on Kosovo! The Summit of a Community without Identity!

26 IN FOCUS

- A century in the making — what Prime Minister of Great Britain, Keir Starmer's visit to Albania really means.

29 BALKAN OVERVIEW

- How the EU Abandoned Democracy in Kosovo.

31 GLOBAL

- Charlemagne Prize/ Von der Leyen honoured for advancing European unity.

“EVROPA E RE NË NJË BOTË TË RE...”, SHQIPËRIA MIKPRET KOMUNITETIN POLITIK EVROPIAN



Më 16 maj 2025, Shqipëria shkroi një faqe të re në historinë e saj diplomatike, duke pritur në zemër të Tiranës një nga ngjarjet më të rëndësishme politike të kontinentit: Samitin e gjashtë të Komunitetit Politik Evropian (KPE). Për herë të parë, ky forum i nivelit të lartë, që bashkon të gjitha shtetet evropiane përtej kufijve institucionalë, u zhvillua në një vend të Ballkanit Perëndimor, duke i dhënë Shqipërisë një rol të spikatur në hartën gjeopolitike të Evropës.

Në Sheshin “Skënderbej”, nën masa të jashtëzakonshme sigurie dhe vëmendjen e mediave ndërkombëtare, u mbledhën 47 liderë shtetesh dhe qeverish, së bashku me përfaqësues të Bashkimit Evropian, NATO-s, OSBE-së dhe Këshillit të Europës. Nën bashkë-organizimin e Presidentit të Këshillit Evropian, António Costa, dhe Kryeministrit shqiptar, Edi Rama, Samiti

Në Sheshin “Skënderbej”, nën masa të jashtëzakonshme sigurie dhe vëmendjen e mediave ndërkombëtare, u mbledhën 47 liderë shtetesh dhe qeverish, së bashku me përfaqësues të Bashkimit Evropian, NATO-s, OSBE-së dhe Këshillit të Europës. Nën bashkë-organizimin e Presidentit të Këshillit Evropian, António Costa, dhe Kryeministrit shqiptar, Edi Rama, Samiti shënoi një moment kulmor për diplomacinë shqiptare dhe për vetë rajonin.

shënoi një moment kulmor për diplomacinë shqiptare dhe për vetë rajonin.

Evropa e re në një botë të re
Nën moton “Evropa e re në një botë të re: unitet – bashkëpunim – veprim i përbashkët”, Samiti në Tiranë i dha zë sfidave aktuale që po tronditin arkitekturën e rendit ndërkombëtar: lufta në Ukrainë, presionet ekonomike, kërcënimet hibride, ndryshimet klimatike dhe transformimi teknologjik. KPE ka marrë formën e një

forumi politik fleksibël, që nuk zëvendëson strukturat ekzistuese si BE apo NATO, por i plotëson ato me një hapësirë për dialog të sinqertë dhe bashkëpunim të gjerë. Në këtë frymë, Shqipëria u paraqit jo thjesht si mikpritëse, por si një urë lidhëse mes rajonit të Ballkanit dhe të ardhmes evropiane. Samiti i Tiranës zhvillohet në një kohë kur Evropa ndodhet në një pikë kritike. Një luftë vazhdon në krahun e saj lindor. Tensionet po rriten globalisht. Kërcënimet hibride, shtrëngimi ekonomik

dhe ndërprerjet teknologjike po testojnë qëndrueshmërinë demokratike dhe kërkojnë përgjigje më të koordinuara evropiane. Në këtë kontekst, Komuniteti Politik Evropian shfaqet si një forum jetik për unitet—një forum që kalon kufijtë institucionale dhe bashkon të gjithë kombet evropiane për të shkëmbyer ide, për t'u përballuar me sfidat e përbashkëta dhe për të hartuar një kurs të përbashkët përpara. Duke u mbështetur mbi dinamizmin e samiteve të mëparshme në Pragë, Moldavi, Spanjë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Hungari, Samiti i Komunitetit Politik Evropian në Tiranë do të shërbejë si një platformë për dialog politik të hapur politik dhe bashkëpunim konkret. Agjenda do të reflektojë çështjet më urgjente për qytetarët evropianë sot, duke ofruar gjithashtu hapësirë për të parë përpara me qartësi dhe ambicie.

Temat qendrore të Samitit

Samiti u strukturua në katër tryeza të nivelit të lartë, duke përfshirë liderë të shteteve më të fuqishme të kontinentit. Në fokus ishin çështje me rëndësi jetike për qytetarët evropianë:

1. Siguria dhe qëndrueshmëria demokratike

Diskutimet u përqendruan në mbështetjen për Ukrainën, ruajtjen e paqes, forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes kolektive dhe mbrojtjen e proceseve demokratike nga ndërhyrjet e huaja.

2. Konkurrueshmëria dhe siguria ekonomike

Liderët trajtuan mënyrat për



Komuniteti Politik Evropian

KPE ka marrë formën e një forumi politik fleksibël, që nuk zëvendëson strukturat ekzistuese si BE apo NATO, por i plotëson ato me një hapësirë për dialog të sigurtë dhe bashkëpunim të gjerë. Në këtë frymë, Shqipëria u paraqit jo thjesht si mikpritëse, por si një urë lidhëse mes rajonit të Ballkanit dhe të ardhmes evropiane.

të rritur inovacionin, qëndrueshmërinë energjetike, dhe autonominë strategjike, për të mbrojtur zinxhirët kritikë të furnizimit dhe për të përballuar sfidat e tranzicionit të gjelbër.

3. Migracioni, lëvizshmëria dhe të rinjtë

Në këtë tryezë u shqyrtuan zgjidhje të koordinuara për migracionin e rregullt, ruajtjen e talentëve dhe përgatitjen e brezit të ri për sfidat e epokës digjitale dhe inteligjencës artificiale.

4. Lider shipi dhe veprimi european në skenën globale

Tryeza e fundit ishte një thirrje për një Evropë më të vendosur, më përfshirëse dhe më fleksibël

në reagimet e saj ndaj krizave globale dhe sfidave të ardhshme.

Një moment historik për Shqipërinë

Për Shqipërinë, ky samit ishte shumë më tepër se një organizim protokollar. Ai përfaqëson:

- **Rritjen e kredibilitetit ndërkombëtar**
- **Pozicionimin e Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon**
- **Promovimin e axhendës së saj për integrimin në Bashkimin Evropian**

Gjithashtu, samiti shërbeu si një dritare për të promovuar kulturën, historinë dhe modernizimin e Tiranës, që për një ditë u kthye në kryeqytetin politik të kontinentit.

Samiti i Tiranës nuk ishte thjesht një ngjarje e rrallë diplomatike, por një dëshmi e qartë se Shqipëria **është** shndërruar në një faktor real stabiliteti në Ballkanin Perëndimor dhe në një partnere të besueshme në tryezën evropiane. Duke u pozicionuar në zemër të dialogut mbi të ardhmen e kontinentit, vendi ynë konfirmoi përkushtimin e tij ndaj vlerave të demokracisë, bashkëpunimit dhe sigurisë kolektive. Në një kohë kur Evropa ka nevojë për unitet më shumë se kurrë, Shqipëria tregoi se **është** jo vetëm pjesë e diskutimit, por edhe pjesë e zgjidhjes. Ky samit shënon një tjetër hap të rëndësishëm në rrugëtimin e vendit drejt integritetit të plotë në Bashkimin Evropian jo thjesht si një aspiratë, por si një e ardhme që po merr gjithnjë e më shumë formë.

HABEMUS PAPAM:

Leo XIV është Papa i zgjedhur për të udhëhequr Kishën Katolike

*Habemus Papam! Sot Konklavi zgjodhi Kardinalin
Robert Francis Prevost Ipeshkëv të 267-të të Romës*



Kardinali amerikan, Robert Francis Prevost, është zgjedhur udhëheqësi i ri i Kishës Katolike Romane më 8 maj dhe ka zgjedhur emrin Leon XIV.

Ai është papa i 267 i Kishës Katolike dhe amerikan i parë që është zgjedhur papë.

Zgjedhja e tij u bë në votimin e tretë të enjten, në ditën e dytë konklavës.

Njoftimi për zgjedhjen e tij u bë nga një kardinal nga ballkoni në Bazilikën e Shën Pjetrit i cili shqiptoi fjalët latine “habemus papam” (kemi papën e ri).

“Paqja qoftë me të gjithë ju”, ishin fjalët e para të papës amerikan nga ballkoni i Bazilikës së Shën Pjetrit.

Ai tha se dëshiron që mesazhi i paqes “të hyjë në zemrat e huaja, të arrijë te familjet tuaja dhe të gjithë njerëzit, kudo që jeni”.

Duke nderuar paraardhësin e tij, Papa Françeskun, ai u bëri thirrje besimtarëve “të ecni përpara, pa frikë, të bashkuar, dorë për dorë me Zotin dhe njëri-tjetrin.

Papa Leoni XIV falënderojë kardinalët që e zgjodhën që të udhëheqë Kishën Katolike.

Pas zgjedhjes së papës së ri, presidenti amerikan, Donald Trump, tha se “është shumë nder që ai është papa i parë që është amerikan”.

“Çfarë emocioni dhe çfarë nderi të madh për vendin tonë. Mezi pres ta takojë Papë Leonin e 14-të. Do të jetë një moment shumë i rëndësishëm”, tha Trump.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj uroi sot besimtarët katolike për zgjedhjen e Papës së ri.

“Urime katolikëve shqiptarë dhe atyre të gjithë botës për zgjedhjen e Papës së ri!” shkroi Presidenti Begaj në profilin e tij zyrtar në



llogaritë sociale në platformën X dhe facebook.

”Shpreh bindjen, – vlerësoi Presidenti i Republikës, – se Ati i Shenjtë, Papa Leoni XIV, do të kontribuojë me gjithë fuqinë dhe autoritetin e tij në shërbim të kauzës sublime të forcimit të klimës së bashkëjetesës paqësore të të gjitha besimeve.”

Në emër të shqiptarëve Presidenti Begaj uroi që papa Leone XIV të jetë nën mbrojtjen e Zotit për realizimin e misionit të tij të shenjtë në krye të Vatikanit.

Ndërkaq, edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, uroi për zgjedhjen e kreut të ri të Kishës Katolike.

“Në një kohë kur bota ka nevojë për paqe, unitet dhe dhembshuri, zëri i tij do të ketë peshë të madhe. Uroj që pontifikati i tij të shquhet për qartësi morale, udhëheqje të paluhatshme dhe një angazhim të thellë për dinjitetin e gjithë njerëzimit”, shkroi ajo në X.

Tymi i bardhë – që sinjalizon zgjedhjen e papës – u pa duke dalë nga oxhaku i Kapelës Sistine disa minuta pas orës 18:00 të 8 majit.

Shumë njerëz panë tymin e parë duke dalë nga oxhaku, teksa u mbledhën në Sheshin e Shën Pje-

trit, në Vatikan.

Ndërkaq, pas zgjedhjes së papës së ri, në Katedralen Nëna Terezë në Prishtinë kanë rënë kambanat për të njoftuar besimtarët për zgjedhjen e kreut të ri të Kishës Katolike.

Kush është Papa i ri, Robert Francis Prevost?

Papa i parë augustinian, Papa i dytë amerikan pas Françeskut, por ndryshe nga Bergoglio, amerikan 69-vjeçar Robert Francis Prevost u lind në veri të kontinentit dhe shërbeu si bari i Kishës në jug të tij, përpara se të thirrej nga Paraardhësi i tij për të drejtuar Dikasterin për Ipeshkvijtë dhe Komisionin Papnor për Amerikën Latine.

Ipeshkvi i ri i Romës zgjodhi emrin e Leonit XIV. U lind më 14 shtator 1955 në Çikago, Illinois, nga Louis Marius Prevost, me origjinë franceze dhe italiane, si edhe nga Mildred Martínez, me origjinë spanjolle. Ka dy vëllezër, Louis Martín dhe John Joseph.

E kaloi fëmijërinë dhe adoleshencën në SHBA, duke studiuar fillimisht në seminarin e vogël të Etërve Augustinianë dhe më pas, në Villanova University në Pensilvani, ku, në vitin 1977, u diplomua në Matematikë dhe studioi Filozofi. Më 1 shtator të po atij viti, në Saint Louis, hyri ndër novicët (rishtarët) e Urdhrit të Shën Augustinit (OSA), në provincën e Zojës së Këshillit të Mirë të Çikagos, duke bërë kushtet e para më 2 shtator 1978. Më 29 gusht 1981 bëri kushtet përfundimtare.

Vijoi formimin në Catholic Theological Union në Çikago, duke u diplomuar në Teologji. Në moshën 27 vjeçare, eprorët e dërguan në Romë për të studiuar

të Drejtën Kanonike në Universitetin Papnor të Shën Tomës së Akuinit (Angelicum). Në Romë, u shugurua meshtar më 19 qershor 1982, në Kolegjin Augustinian të Shën Monikës nga imzot Jean Jadot, pro-president i Këshillit Papnor për Jo-të Krishterët, tani Dikasteri për Dialogun Ndërfetar. Prevost mori licencën, pra, diplomën universitare, në vitin 1984 dhe në vitin pasardhës, ndër-sa përgatiste tezën e doktoraturës, u dërgua në misionin augustinian të Chulucanas, në Piura të Perusë (1985-1986). Më 1987 mori doktoraturën me një tezë mbi “Rolin e eprorit lokal të Urdhrit të Shën Augustinit” dhe u emërua drejtor i thirrjeve dhe drejtor i misioneve të Provincës augustiniane të “Nënës së Këshillit të Mirë” në Olympia Fields, Illinois.

Vitin e mëpasëm shkoi në misionin e Trujillo-s, gjithnjë në Peru, si drejtor i projektit të formimit të përbashkët të aspirantëve augustinianë të vikariateve të Chulucanas, Iquitos dhe Apurímac. Gjatë njëmbëdhjetë viteve, mbajti detyrën e eprorit të bashkësisë (1988-1992), drejtorit të formimit (1988-1998) dhe mësuesit të të kandidatëve për augustinianë (1992-1998), si edhe, në kryedioqezën e Trujillo-s, atë të vikarit gjyqësor (1989-1998) dhe të profesorit të së Drejtës Kanonike, Patristikës dhe Moralit në seminarin e madh “San Carlos y San Marcelo”. Në të njëjtën kohë, atij iu besua edhe kujdesi baritor i grigjës së besimtarëve të Zojës Nënë e Kishës, e cila më vonë u bë famulli me titullin e Shën Ritës (1988-1999), në periferinë e varfër të qytetit, si edhe ishte administrator i famullisë së Zojës së Monserrat-it nga viti 1992 deri në vitin 1999.

Në vitin 1999, u zgjodh epror provincial i Provincës Augustiniane të “Nënës së Këshillit të Mirë” në Çikago dhe, dy vjet e gjysmë më vonë, në kapitullin e përgjithshëm të zakonshëm të Urdhrit të Shën Augustinit, sivëllezërit e tij e zgjodhën epror të përgjithshëm, duke e konfirmuar në vitin 2007 për një mandat të dytë.

Në tetor 2013, u kthye në Provincën e tij Augustiniane në Çikago dhe u bë drejtor i Formimit në kuverndin e Shën Augustinit, këshilltar i parë dhe vikar provincial; detyra, që i mbajti derisa Papa Françesku e emëroi, më 3 nëntor 2014, administrator apostolik të dioqezës peruviane të Chiclayo-s dhe, njëkohësisht, ipeshkëv titullar të Sufarit. Më 7 nëntor, hyri në dioqezë, në prani të nuncit apostolik James Patrick Green, i cili e shuguroi ipeshkëv pak më shumë se një muaj më vonë, më 12 dhjetor, në festën e Zojës së Guadalupe, në katedralen e Shën Marisë.

Motoja e tij ipeshkvnore është “In Illo uno unum”, fjalë që Shën Augustini i shqiptoi në një predikim, “Paraqitje mbi Psalmin 127”, për të shpjeguar që “edhe pse ne të krishterët jemi shumë, në Krishtin jemi një”.

Më 26 shtator 2015, Papa argjentinës e emëroi ipeshkëv të Chiclayo-s dhe në mars 2018, u zgjodh zv.kryetar i dytë i Konferencës Ipeshkvnore Peruviane, në të cilën ishte edhe anëtar i Këshillit Ekonomik dhe president i Komisionit për Kulturë dhe Edukim.

Në vitin 2019, Françesku e përfshiu ndërmjet anëtarëve të Kongregatës për Klerin dhe vitin e mëpasëm, ndërmjet atyre të Kongregatës për Ipeshkvijtë. Po në vitin 2020, më 15 prill, mbërrin edhe emërimi papnor si administrator apostolik i dioqezës peruvi-

ane të Callao-s.

Më 30 janar 2023, Papa e thirri në Romë si prefekt të Dikasterit për Ipeshkvijtë dhe president të Komisionit Papnor për Amerikën Latine, duke e bërë kryepeshkëv. Në Konkistorin e 30 shtatorit të po atij viti, ai e krijoi dhe e shpalli kardinal, duke i caktuar diaconinë e Shën Monikës. Prevost e mori në dorëzim më 28 janar 2024 dhe, si kryetar dikasteri, mori pjesë në udhëtimet e fundit apostolike të Papës Françesku dhe në sesionin e parë e të dytë të Asamblesë XVI të Përgjithshme e të Zakonshme të Sinodit të Ipeshkvijve mbi sinodalitetin, mbajtur në Romë përkatësisht nga 4 deri më 29 tetor 2023 dhe nga 2 deri më 27 tetor 2024. Një përvojë, kjo e asambleve sinodale, e fituar që në të kaluarën si epror i augustinianëve dhe si përfaqësues i Bashkimit të Eprorëve të Përgjithshëm (USG).

Ndërkohë, më 4 tetor 2023, Françesku e caktoi Prevost-in anëtar të Dikasterit për Ungjillëzimin, Seksioni për Ungjillëzimin e Parë dhe për Kishat e Reja të Veçanta; të atij për Doktrinën e Fesë; të atij për Kishat Lindore; të atij për Klerin; të atij për Institutet e Jetës Rregulltare dhe Shoqëritë e Jetës Apostolike; të atij për Kulturën dhe Edukimin; të atij për Tekstet Legjislative; si edhe në Komisionin Papnor për Shtet-Qytetin e Vatikanit.


Së fundi, më 6 shkurt të këtij viti, u promovua nga Papa argjentinës në urdhrin e ipeshkvijve, duke marrë Titullin e Kishës Suburbikare të Albanos. Gjatë shtrimit të fundit në spital të paraardhësit të tij në Poliklinikën “Gemelli”, Prevost kryesoi rruzaren për shëndetin e Françeskut, në Sheshin e Shën Pjetrit, më 3 mars.

Zgjedhjet bëhen për të ofruar zgjidhje. 11 maji e humbi këtë shans

Nga AFRIM KRASNIQI

Votimet mbaruan duke konfirmuar hendekun në sondazhe, – mazhoranca fitoi mandatin e katërt dhe për paradoks, më me shumë mandate sesa të gjitha mandatet e mëparshme. Statistikisht nuk ka surprizë, – PS ka thuar se të njëjtin numër votash si në tri zgjedhjet e mëparshme, duke pasur nivel mobiliteti të strukturës së vet patronazhiste në nivele 95%-98%, por ka rritje të numrit të mandateve për shkak se votat pro PD+LSI kanë rënie të ndjeshme në raport me zgjedhjet e kaluara.

Niveli i mobilitetit tek opozita varion midis 55%-60% e pamjaftueshme për të siguruar pjesëmarrjen në votim as të votuesve historikë të saj, dhe natyrisht, e pamundur të fitojë votat e pjesës së pavendosur, jo mbështetëse të qeverisë. Aleanca me LSI (PL) nuk funksionoi, shumica e votave të saj klienteliste u rikthyen në PS ose kaluan në PSD, ndërkohë që votuesit asnjans zgjodhën partitë e reja. Natyrisht PS krijoi një sistem patronazhizmi që njëson partinë, shtetin, oligarkinë, informalitetin dhe “të fortët”, praktikë antiligjore që PS e testoi edhe më 2017 dhe 2021. Në çdo rast referues të njëjtë në botën demokratike opozitat kanë pasur sukses



kur reformohen, frymëzojnë me ide, hapen ndaj prurjeve cilësore dhe luftojnë me kartat morale, katër cilësi që PD+ i refuzoi me arrogancë.

Zgjedhjet bëhen për të ofruar zgjidhje. 11 maji e humbi këtë shans. Ata që ishin konfirmuan vetveten dhe besnikët. Risitë janë minimale dhe jo vendimmarrëse. Katër herë një parti ka pasur mbi 80 mandate, 1991, 1992, 1996 dhe 1997, vetëm në një rast ato prodhuan reforma dhe progres (1992), kur de facto nuk ishte votë partie, por votë për ndryshim sistemi. Vazhdimi dihet: mazhoranca do shijojë mbipushtetin e pa shqetësuar, do të kemi dobësim të ndjeshëm të jetës parlamentare, të kontrollit e balancës së pushteteve, të rolit të institucioneve të pavarura dhe natyrisht, rënie të lirë të standardeve të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës. Opozita? Shih listën e mbyllur të Tiranës dhe e kuptojmë si do jetë, opozita që çdo qeveri do të donte të kishte. Do kemi protesta, kontes-

time, shoë, marrëveshje të reja, kulla të reja, por jo dorëheqje dhe as llogaridhënie.

Drejtësia do hetojë ca raste fatkeqe të individëve që u detyruan të fotografojnë votën, por jo ata që urdhëruan fotografimin e votës dhe as sistemin korruptiv, i cili, duke ci-tuar opozitën e 2009-2012, “vjedh Shqipërinë për të vjedhur vota dhe më pas vjedh vota për të vjedhur Shqipërinë”. Ata nuk ndryshuan këtë sistem korruptiv, thjesht e perfeksionuan atë.

Kur demokracia devijon, populizmi merr vendime, militantët kontrollojnë pushtetin dhe ide-të moderatore refuzohen, është detyrë dhe përgjegjësi e pakicës, – zërave me integritet, të flasin, të veprojnë dhe të reagojnë më shumë, të refuzojnë status quo-n & establishmentin e korruptuar politik dhe të ushqejnë sa munden dije, kulturë e shpresë në vendin ku nga Kalimashi, Q.Murritzit, Elbasani dhe deri në Llogara gjendet e njëjta parullë domethënëse dhe konsensuale “mirë se erdhët në tunel”.

EVROPË, FALEMINDERIT PËR ASGJË!

Nga DEJAN AZESKI- IFIMES*

Për ata prej nesh që nuk e kujtojnë Jugosllavinë që nga lindja jonë, na thuhet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian si e vetmja rrugë drejt së ardhmes sonë më të ndritur. Jemi pothuajse të detyruar të përjetojmë atë krijim sublim si Qytetet e Zanave në përrallat popullore perëndimore. Është sikur presim pafundësisht që zanat të fluturojnë dhe të na pjalmojnë me pluhurin e pranverës dhe prosperitetit të përjetshëm.

Por në të njëjtat përralla, si rregull, kudo që ka zana, ka edhe orkë të maskuar që jetojnë diku nën tokë, si insekte që ushqehen me mbetjet e pjesës tjetër të botës kulturore. Shumë nga brezi im ishin adhurues të singertë të arritjeve mjeshtërore të filmit si Harry Potter ose Zoti i Unazave derisa në një moment kuptuam kolektivisht se në perspektivën e kombeve themeluese të familjes evropiane: orkëve, goblinëve, trollëve dhe të gjitha krijesave të tjera të neveritshme, në të vërtetë jemi ne ata që kemi pritur për 35 vjet (ose saktësisht që nga viti kur lindi unë) nën muret mesjetare të Bashkimit Evropian.

Kjo pritje e pafundme nuk do të ishte kaq e tmerrshme nëse do të kishte një kriter të qartë dhe parimor për rrugën që duhet ndjekur drejt "Olimpit qytetërues". Në përgjithësi, të gjithë jemi të vetëdijshëm se në shumë fusha ne vërtet nuk e meritojmë të jemi në të njëjtin nivel me Gjermaninë,



Holandën, Lihtenshtajnin, Monakon dhe shumë vende të tjera më të vogla dhe më të mëdha të kontinentit tonë. Por kur përfitimet e të njëjtit Bashkim Evropian janë përdorur për dekada nga fqinjët tanë të afërt Bullgaria ose Rumania, dhe kur ka një diskutim të madh për pranimin e Moldavisë, i cili ndoshta nuk do të jetë në nivelin ku jemi tani pas një mijë vjetësh, atëherë atomet e fundit të dinjitetit tonë fillojnë të ziejnë vërtet.

Duke u mbushur kupa e durimit Kupa e durimit tonë po mbushet gjithashtu me deklarata zyrtare nga zyrtarë të lartë të Unionit, sipas të cilave: ata duhet ta ridrejtojnë Moldavinë, Ukrainën, Gjeorgjinë dhe vende të ngjashme në korsinë e shpejtë – sepse nëse do të kishin pritur të na bashkoheshin, ndoshta kjo nuk do të kishte ndodhur kurrë. Sikur ne jemi fajtorë për faktin se vendet e Unionit nuk e dinë fjalë për fjalë se cilën rrugë të ndjekin si në politikën e jashtme ashtu edhe në

atë të brendshme, kështu që në të gjithë atë kaos ata e lanë mënjanë pafundësisht anëtarësimin tonë.

Ajo iniciativë e vogël nga Hungaria, nga presidenca e së cilës e Unionit prisnim sinqerisht shumë më tepër, ishte gjithashtu sinqerisht zhgënjyese për ne. Megjithatë, vendi me të cilin Maqedonia dhe Serbia kanë marrëdhëniet më të ngushta nuk ka arritur të bëjë asgjë domethënëse për të çuar proceset përpara.

Është shumë fat që sigurisht nuk do të zhgënjehemi nga presidenca polake, sepse sipas politikës së saj aktuale, nuk mund të presim asgjë të veçantë nga ai vend. Atje, i gjithë fokusi është vendosur qartë në përhapjen e armiqësisë dhe urrejtjes ndaj Rusisë si armiku i tyre i vërtetë ose i imagjinuar, gjë që na tregon me siguri paraprakisht se e gjithë energjia në dhjetë muajt e ardhshëm do të drejtohet në atë drejtim dhe për ne nga Ballkani Perëndimor, asgjë nuk do të bëhet përsëri.

Sa i përket kryetarit të ardhshëm

të unionit, kushdo që të jetë ai, ndoshta nuk do të arrijmë as të shohim nëse do të bëjë diçka më shumë apo jo, sepse çdo vend nga Ballkani Perëndimor do të shkojë në rrugën e vet. Si për shembull, Maqedonia me partneritetin e saj strategjik me Britaninë e Madhe, i cili doli fjalë për fjalë nga hiçi si një rrufe.

Por ky nuk është ndonjë skenar i ri dhe i paprecedentë për ne ish-jugosllavët. Për historianët, interesante për analizë janë pamjet televizive nga qyteti i vogël kufitar slloven Ilirska Bistrica, ku në vitin 1991 fjalë për fjalë e gjithë popullsia doli për të bllokuar kolonitë e ish-Ushtrisë Popullore Jugosllave që po shkonin si përforcime për të siguruar postet doganore drejt Italisë dhe Austrisë. Vërtet tingëllon e pamundur që në vitin 1989 Sllovenia të ishte kaq besnike ndaj vëllazërisë dhe unitetit, dhe të njëjtët njerëz vetëm një vit më vonë ishin 100% të gatshëm të dilnin në rrugë kundër të njëjtës Jugosllavi. Kjo mund të shpjegohet vetëm me një logjikë: se zhgënjimi me shtetin e atëhershëm të përbashkët filloi të grumbullohej shumë, shumë më herët. Ndoshta selia qendrore në Beograd kishte bërë lëvizje të gabuara për dekada dhe arriti t'i kthente njerëzit në Slloveni dhe Kroaci kundër vetes deri në atë pikë sa ata ndaluan së ndjeri shtetin e përbashkët si të vetin.

Kjo është pikërisht ajo që Brukseli po na bën, dhe në një formë edhe më brutale, me të gjitha këto vonesa të pafundme në anëtarësim dhe negociata dhe me fyerje të hapura. Akti i tretë dhe më i vështirë i kësaj drame të pafundme është e ardhmja shumë e



Gjëja më e frikshme nga të gjitha është se Bashkimi Evropian, konkretisht idetë themelore mbi të cilat bazohet, nuk u nevojitën Ballkanit për udhëtimin pa viza në Paris, por përkundrazi që vlerat dhe idetë e tyre të bëheshin balsam për plagët që mbart ky rajon.



paqartë e unionit, për të cilin nuk shohim një drejtim të qartë se në cilin po shkon. Nëse analizojmë të gjithë historinë, format federale dhe konfederale të aleancave nuk kanë zgjatur kurrë më shumë se gjysmë shekulli mesatarisht. Bashkimi Evropian, si pasardhës i Komunitetit Ekonomik për Qymyrin dhe Çelikut, me të vërtetë ka arritur ta tejkalojë atë numër magjik, por në vitet kur duhet të kishte qenë më i forti, humbi deri në 35 vjet pa arritur ta evropianizojë Ballkanin të paktën pak dhe të zgjerojë këtu të paktën një pjesë të pozicioneve të tij. Këto praktika padyshim ekzistojnë. Prandaj, ekziston një frikë e drejtë midis intelektualëve progresivë në këto rajone se breza të

tërë të majtësh, liberalësh dhe në përgjithësi njerëzve që luftojnë për demokraci janë tradhtuar nga lidershipi virtual në Bruksel dhe se nuk do të ketë askush për t'i zëvendësuar ata. Pra, askush nuk është aq i çmendur sa të përsërisë gabimet që kanë bërë shumë udhëheqës politikë premtues në Ballkan.

Gjëja më e frikshme nga të gjitha është se Bashkimi Evropian, konkretisht idetë themelore mbi të cilat bazohet, nuk u nevojitën Ballkanit për udhëtimin pa viza në Paris, por përkundrazi që vlerat dhe idetë e tyre të bëheshin balsam për plagët që mbart ky rajon. Tani që tashmë po bëhet e qartë se Bashkimi Evropian është zhdukur ose të paktën se do të zhduket në të ardhmen e parashikueshme, mund të pyesim veten se çfarë na pret më pas. A është një kthim në të kaluarën e errët të viteve 1990 apo një kthim edhe më i tmerrshëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë kur kufijtë e perandorive të mëdha do të zgjerohen përsëri në Ballkan dhe shtizat e mosmarrëveshjes do të thyhen përsëri këtu, dhe ne të gjithë i shërbejmë ato vetëm si monedhë për ndryshim. Në momentin që po shkruhet ky tekst, 28 maj 2025, mund të themi me siguri: Evropë, faleminderit për asgjë.

Përshtati në shqip: Argumentum.al

Titulli "Evropë, faleminderit për asgjë!" është i zgjedhur nga Redaksia.

Titulli origjinal: "Brezat e Humbur të Unionit Virtual"

**<https://www.ifimes.org/en/researches/the-lost-generations-of-the-virtual-union/5519>*

Kështu po! Kuarteti i shpresës! Turp për Prishtinën! Samiti i Komunitetit pa identitet!

REAL POLITIK NR. 107 | 1 - 17 MAJ 2025 | EKSLUZIVE PËR ARGUMENTUM

Komente “flash” mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, vetëm me 1000 fjalë nga analisti i njohur



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Kështu po! E kemi fjalën për qëndrimet më të fundit të Presidentit Trump në politikën e jashtme. Pas hapave të nxituara dhe ultimatumave fillestare, tani ai “po i thërret” mendjes dhe i është futur logjikës normale të punëve. Sepse e kuptoi që në gjeopolitikë, problemet nuk zgjidhen si në biznes, as me frymën e shenjtë dhe as me një të rënë të shkopit. Kërkohej kujdes, konsultim me aleatët, strategji të mirëmenduara dhe të mirërenditura. Konkretisht,

gjatë këtyre dy javëve të fundit SHBA-të biseduan dhe bënë marrëveshje tregtare me Britaninë e Madhe, dhe me Kinën; vetë Trump ishte dhe nënshkroi marrëveshje qindra miliarda dollarë me tri vende të mëdha të Gjirit; po ashtu, ai shtoi tryshninë ndaj Putinut për t’u angazhuar për paqe; gjithashtu ai dërgoi sekretarin e Shtetit Marco Rubio në Stamboll në bisedimet e paqes me Rusinë dhe Ukrainën të ndërmjetësuar nga Turqia; Rubio është gjithashtu në kontakt me kolegët europianë, etj. Ndërkohë, Zv.Presidenti Vance pohoi se SHBA-të janë bashkë me Europën. Ndaj, mund ta themi me plot gojën “Kështu PO”!

2.

Kuarteti i shpresës! Më 10 Maj, Macron, Merz, Starmer dhe Tusk shkuan së bashku në shenjë solidariteti në Kiev, ku takuan Presidentin Zelenski. Aty ata rikonfirmuan në mënyrë bindëse mbështetjen e vendosur të 4 vendeve të tyre për Ukrainën dhe ndihmesën në vendosjen dhe garantimin e paqes. Kjo vizitë e këtij kuarteti madhor europian u përshëndet nga të gjithë dhe pati jehonë të gjerë publike. Siç pohojnë mediat kryesore të këtyre vendeve dhe më gjerë, me mesazhet e saj të shumëpritura, kjo vizitë ringjalli shpresat te Europa, sidomos te boshti franko-german të

BE-së, bashkëpunimi i tij me Britaninë e Madhe dhe Poloninë, dy vende me një sistem të fuqishëm mbrojtjeje.

Gjithashtu, biseda telefonike e Kancelarit gjerman Merz dhe liderëve të tjerë nga Kievi me Presidentin Trump ishte tejet inkurajuese për procesin e armëpushimit dhe paqes në Ukrainë, çka u duk dhe në dakordësinë e tyre për vensdosjen e një armëpushimi 30 ditor dhe bisedimet e paqes në Stamboll më 16 maj. Ndaj, me të drejtë flitet për "kuartetin e shpresës së madhe europiane"

3.

Turp për Kosovën!

Këtë e themi me keqardhje për politikën në Prishtinë e cila, mbas 17 raunde votimesh të pakuptimta, dhe tani, 100 ditë mbas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare të 9 Shkurtit nuk po zgjedh dot ende Kryetarin e Kuvendit. Ndërkohë, që po kërkon



me ngulm të anëtarësohet në KiE dhe në BE, meqenëse i ka plotësuar kriteret dhe kërkesat përkatëse. Edhe pse ato nuk kanë kuptim përballë një dështimi të tillë. Kur Berlini që i bëri zgjedhjet e parakohshme 2 javë më vonë se Kosova e zgjodhi Kryetaren e Kuvendit dhe koalicionin qeveritar në kohën rekord prej 75 ditësh! Koha për Europën nuk pret, ndërsa për Kosovën mesa duket PO!

Faji është i gjithë klasës politike, duke filluar nga qeveria dhe Kryeministri Kurti. Me qëndrime politike "kokëmushkë"-

o Albulenën o rashë e vdiq" ajo nuk po tregon frymë europiane, lëshimi dhe kompromisi. Tani, megjithë respektin për Zonjën Ministre Albulena, prapë, sado e mirë të jetë, kur të tjerët nuk duan, me të drejtë apo pa të drejtë, nuk ka pse këmbëngulet më. Ka patur plot burra dhe gra si ajo në Kosovë dhe gjetkë, ndoshta dhe më të mirë e të aftë dhe kanë dështuar në këtë drejtim; se kjo është demokracia, konsensus. Ndaj, është koha që politika dhe Prishtina të reflektojnë drejt, të mblidhen bashkë dhe të gjejnë rrugëdaljen nga kjo krizë absurde që i bën shumë dëm brenda, por dhe imazhit të saj jashtë vendit.



Faji është i gjithë klasës politike, duke filluar nga qeveria dhe Kryeministri Kurti. Me qëndrime politike "kokëmushkë"- o Albulenën o rashë e vdiq" ajo nuk po tregon frymë europiane, lëshimi dhe kompromisi. Tani, megjithë respektin për Zonjën Ministre Albulena, prapë, sado e mirë të jetë, kur të tjerët nuk duan, me të drejtë apo pa të drejtë, nuk ka pse këmbëngulet më.

4.

Samiti i Komunitetit pa identitet!

Më 16 Maj, Tirana mikpritte me sukses Samitin e 6-ë të Komunitetit Politik European (KPE) me praninë e 54 liderëve të Europës, të NATO-s, BE-së, etj. Padyshim ngjarje e madhe me rëndësi për politikën, diplomacinë dhe imazhin e vendit për të cilën qeveria dhe Kryeministri Rama meritojnë përgëzimet e rasis.

Gjithsesi, jehona e këtij Samiti dhe Komuniteti të krijuar në Qershor 2022 nga Presidenti francez Macron nuk pritej të ishte më e madhe. Kjo për shkak dhe





të bilancit tejet të varfër të KPE-së: vetëm me 5 samite në Pragë, Kisinau, Alhambra (Spanjë) në Londër, Budapest dhe i gjashti në Tiranë.

Samitet e saj, si e vetmja « shenjë jetese » karakterizohen kryesisht nga diskutime të lira, 3 – 4 në tryeza dhe panele mbi tematikat shqetësuese të kohës.

Krahas këtyre bisedave në mjedis të këndshme dhe dëfryese, liderët europianë kanë rastin të shijojnë pijet dhe specialitetet kulinare, atraksionet turistike dhe në përgjithësi "talk and eating"! (fol dhe ha).

Kjo ndodh mbasi dhe Katalogu « i

KPE-së, krejt ndryshe nga KiE-ja, OSBE-ja, BE-ja, NATO apo dhe grupime rajonale është plot me "PA" – PA adresë, PA seli, PA shtëpi, PA Sekretariat, PA strukturë drejtuese, PA axhendë, PA program dhe PA plan, Pa vendime, PA kundërshtime, PA deklarata shtypi, PA asnjë format ministrior dhe ekspertësh. Vetëm me "diplomaci të butë dhe sharmi", që të gjitha të ndejnë vehten si në shtëpinë e tyre, të mos vihen në siklet, të ndihen rehat apo « si një intimitet strategjik » siç e ka quajtur Presidenti Macron». Kësisoj, këto samite janë bërë, siç i thonë fjalës, "hatër pa prishur

dhe punë pa bitisur".

Mirëpo ky përbën shqetësim të madh, pasi dhe nga ana organizative, ky forum Paneuropian nuk mund të vazhdojë të funksionojë më si dekor diplomatik. Ndryshe, siç paralajmërojnë shumë ekspertë politikë dhe mediatikë, ajo mund të katandiset në një forum simbolik, në një organizatë shtetërore jo-qeveritare, në një platformë pa bosht, pa taban, « pa bukë» dhe pa besueshmëri.

Mirëpo nga ana tjetër as vetë KPE-ja dhe ata brenda saj nuk po dijnë çtë bëjnë dhe në cilën "ombrellë" të futet; kjo mbasi të gjitha rrugët dhe shtigjet, hapësirat dhe tematikat gjeopolitike e demokratike janë zënë me kohë, nga BE-ja, NATO-ja, KiE-ja, OSBE-ja dhe grupime të tjera. Për pasojë, në « një stadium futbollit politik ndërkombëtar» KPE-ja do të detyrohet të "qëndrojë në këmbë" ose "përballë" por jo në « Tribunën VIP. »

Megjithë respektin për Zonjën Ministre Albulena, prapë, sado e mirë të jetë, kur të tjerët nuk duan, me të drejtë apo pa të drejtë, nuk ka pse këmbëngulet më. Ka patur plot burra dhe gra si ajo në Kosovë dhe gjetkë, ndoshta dhe më të mirë e të aftë dhe kanë dështuar në këtë drejtim; se kjo është demokracia, konsensus.



Gjithsesi, jehona e Samitit të Tiranës ishte më e madhe se mesatarja; kjo falë interesit të madh që kanë shkaktuar zhvillimet lidhur me luftën në Ukrainë, dhe brenda vendit nga fitorja e thellë e PS-së në zgjedhjet e 11 Majit, bashkë me problematikat e shfaqura dhe protestën e opozitës, e cila e ka shpallur se nuk i njeh ato.

Partia Socialiste triumfon në zgjedhjet 2025, siguron mandatin e katërt me 83 mandate

Zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 11 maj 2025 përfunduan me një fitore historike të Partisë Socialiste të Shqipërisë (PS), e cila siguroi 83 mandate në Kuvendin e Shqipërisë, nga 140 gjithsej. Ky rezultat i jep PS-së shumicën absolute dhe i hap rrugën formimit të një qeverie të re të udhëhequr për herë të katërt radhazi nga Edi Rama.

Përfshirja e diasporës – për herë të parë

Një risi në këto zgjedhje ishte votimi i qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, përmes sistemit postar. Më shumë se 195,000 emigrantë kishin të drejtë vote, dhe pjesëmarrja ishte rreth 35%. Votat e diasporës ndikuan në disa qarqe të ngushta si Tirana, Durrësi dhe Elbasani, ku rezultati mes partive kryesore ishte më i ngushtë.

Reagimet politike

Edi Rama, në një deklaratë pas shpalljes së rezultateve, falënderoi shqiptarët për besimin dhe e quajti këtë rezultat një “mandat për të përfunduar transformimin evropian të Shqipërisë”.

“Kjo është fitorja më e madhe në historinë e Partisë Socialiste. Ky është një mandat për të ecur drejt anëtarësimit në BE. Shqipëria do të jetë gati për në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030,” – u shpreh Rama.

Nga ana tjetër, opozita, e përfaqësuar nga Partia Demokratike dhe koalicioni ASHM, hodhi dyshime



mbi rregullsinë e procesit zgjedhor. Sali Berisha deklaroi se zgjedhjet u karakterizuan nga “blerje masive votash, përdorim i burimeve publike dhe presion mbi administratën publike.”

PD pritet të mbledhë strukturat për të vendosur mbi aksionin politik të mëtejshëm, përfshirë protesta të mundshme dhe bojkot të pjesshëm parlamentar.

Vlerësimi i ndërkombëtarëve

OSBE/ODIHR, në raportin paraprak, e përshkroi procesin si “i organizuar mirë” por evidentoi shqetësime të vazhdueshme:

- Përdorimi i burimeve shtetërore nga mazhoranca
 - Kontrolli i medias nga partitë politike
 - Klima polarizuese dhe mungesë besimi në institucionet zgjedhore
- Ndërkohë, Komisioni Evropian dhe ambasadat e BE-së e SHBA-së në Tiranë uruan popullin shqiptar për pjesëmarrjen, duke theksuar nevojën për “respektimin e standardeve demokratike” dhe “zbatimin e reformave

në drejtësi dhe zgjedhje”.

Çfarë pritet më tej?

-Formimi i qeverisë së re pas konstituimit të Kuvendit të ri.

-Edi Rama pritet të emërojë një kabinet të ri, me prurje të reja nga radhët e të rinjve dhe potencialisht një rol më të madh për figura nga diaspora.

-Në planin ndërkombëtar, fokusi do të jetë të hapja formale e kapitujve të anëtarësimit me BE-në deri në fund të vitit 2026, siç e ka paralajmëruar vetë Rama.

Një fitore e madhe me sfida të mëdha përpara

Fitorja e PS në vitin 2025 është një tregues i forcës së saj elektorale, por gjithashtu vendos mbi të barrën e përgjegjësisë së plotë për reformat, zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.

Përballja me opozitën e zhgënjyer dhe sfidat institucionale – përfshirë drejtësinë dhe luftën kundër korrupsionit – do të jenë teste të rëndësishme për qeverinë e katërt të Ramës.

Zgjedhjet parlamentare të Shqipërisë konkurruese dhe të organizuara mirë, por munguan kushtet e barabarta të lojës, thonë vëzhguesit ndërkombëtarë



Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Misionit të OSBE/ODIHR-it publikoi sot gjetjet dhe përfundimet paraprake mbi zgjedhjet parlamentare të 11 majit.

Zgjedhjet për parlamentin e Shqipërisë ishin konkurruese dhe të menaxhuara profesionalisht, autoritetet u përballën me sfidën e organizimit të votimit jashtë vendit për herë të parë dhe kandidatët mund të bënin fushatë kryesisht lirisht, por ato u karakterizuan nga keqpërdorimi i përhapur i burimeve publike dhe pushtetit institucional nga partia në pushtet, ndërsa raportime të shumta për presion mbi punonjësit publikë dhe votuesit e tjerë, si dhe raste frikësimi, ishin shqetësuese, thanë vëzhguesit ndërkombëtarë në një deklaratë sot.

Po ashtu, raporti vlerësoi se administrata zgjedhore e menaxhoi procesin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente.

“Votimi nga jashtë vendit, i cili u zbatua për herë të parë në këto zgjedhje, u menaxhua mirë, pavarësisht marrëveshjes së vonshme politike dhe miratimit të kësaj mase, si dhe disa çështjeve organizative”, thuhet në raport.

Më poshtë një pjesë e gjetjeve të OSBE/ODIHR-it:

“Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ishin konkurruese dhe u zhvilluan në mënyrë profesionale, por u mbajtën në një mjedis shumë të polarizuar dhe pjesëmarrësit nuk gëzonin kushte të barabarta gare. Kandidatët në përgjithësi patën mundësi të bëjnë fushatë lirshëm, edhe pse disa raportuan përballje me intimidime. Administrata zgjedhore e menaxhoi procesin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Votimi nga jashtë vendit, i cili u zbatua për herë të parë në këto zgjedhje, u menaxhua mirë, pavarësisht mar-

rëveshjes së vonshme politike dhe miratimit të kësaj mase, si dhe disa çështjeve organizative.

Partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve administrative gjatë fushatës, duke krijuar një avantazh të padrejtë për shkak të postit. Po ashtu, pati një numër të konsiderueshëm akuzash për ushtrim trysnie ndaj votuesve, veçanërisht ndaj punonjësve të sektorit publik.

Për më tepër, legjislacioni zgjedhor dhe interpretimi i ngushtë i tij nga administrata zgjedhore nuk arritën të parandalonin praktikën abuzive. Përqendrimi i pronësisë së medieve, që dëmton pluralizmin e burimeve të informacionit, së bashku me vetëcensurën midis gazetarëve dhe dominimin e mbulimit mediatic nga dy partitë më të mëdha, kufizuan mundësinë e votuesve për të bërë një zgjedhje të informuar. Përdorimi aktiv i rrjeteve sociale nga pjesëmarrësit në garë, përforcoi një diskurs të fortë

përplasës, ndërsa asnjë autoritet nuk ishte caktuar për të zbuluar përmbajtjen manipuluese dhe të dëmshme.

Mekanizmi i ri i koordinimit mes institucioneve për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet zgjedhore është një zhvillim i mirëpritur, por kërkohet vazhdimësi në zbatimin e tij për të adresuar shqetësimet e vazhdueshme për keqpërdorimet zgjedhore. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e organizuar mirë, por shpesh u vu re mosrespektim i procedurave, si dhe u karakterizua nga një numër incidentesh të frikësimit dhe nxitjes së votuesve, si dhe disa mangësi procedurale dhe të transparencës gjatë numërimit të votave.

Korniza ligjore ofron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, pavarësisht nevojës së vazhdueshme për një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse përmes konsultimeve publike. Mangësitë dhe paqartësitë e evidentuara ulin qartësinë e kornizës ligjore dhe krijojnë pasiguri në zbatimin e saj si në shkronjë, ashtu edhe në frymë.

Ndërsa disa nga rekomandimet e ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës janë adresuar, shumica e rekomandimeve të kahershme – përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore në nivelet e ulëta, raportimin e përkohshëm mbi financimin e fushatës, dhe dispozitat për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm mediatik, përfshirë heqjen e përgjegjësisë penale për shpifje – nuk janë trajtuar ende, çka tregon mungesë vullneti politik për reforma tërësore.

Parlamenti zgjidhet përmes një sistemi të modifikuar zgjedhor



Komisionet në nivelet më të ulëta e administruan procesin në mënyrë efikase dhe transparente, pavarësisht disa ndërprerjeve të shkaktuara nga zëvendësimi i vonuar i anëtarëve të emëruar nga partitë politike, veçanërisht për anëtarët e qendrave të votimit në kuadër të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve.

që kombinon listat e mbyllura dhe ato preferenciale, i cili u prezantua përpara këtyre zgjedhjeve. Disa parti më të vogla argumentuan se ky sistem favorizon dy partitë më të mëdha dhe kufizon ndikimin e votimit preferencial, duke u mundësuar drejtuesve të partive të ruajtje kontroll të konsiderueshëm mbi përfaqësimin në parlament, pjesërisht për shkak të mungesës së demokracisë së brendshme partiake.

Pavarësisht këtyre argumenteve, të cilat disa prej këtyre partive i paraqitën në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata nuk e konsideroi sistemin si anti-kushtetues. Në përgjithësi, përgatitjet teknike për zgjedhjet u realizuan në mënyrë efikase, transparente, sipas afateve të përcaktuara dhe në një mënyrë gjithëpërfshirëse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Megjithatë, disa aktorë e perceptuan disa anëtarë të KQZ-së si të politizuar. Seancat e KQZ-së ishin të hapura për vëzhguesit dhe transmetoheshin drejtpërdrejt. Organizimi i votimit nga jashtë vendit përbënte një sfidë të konsiderueshme dhe u vunë re disa probleme me shpërndarjen e fletëve të votimit; megjithatë, procesi në tërësi u menaxhua mirë.

Komisionet në nivelet më të ulëta e administruan procesin në mënyrë efikase dhe transparente, pavarësisht disa ndërprerjeve të shkaktuara nga zëvendësimi i vonuar i anëtarëve të emëruar nga partitë politike, veçanërisht për anëtarët e qendrave të votimit në kuadër të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve.

DITA E DËSHMORËVE TË KOMBIT

Nderim për heronjtë që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë!

Sot, më 5 maj, përkujtojmë Dëshmorët e Kombit, bijtë dhe bijat që dhanë jetën për lirinë, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari. Kjo ditë ka një simbolikë të veçantë historike, pasi lidhet me rënien heroike të Qemal Stafës më 5 maj 1942, një nga figurat më emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që me veprimtarinë dhe idealet e tij u kthye në simbol të rezistencës shqiptare ndaj fashizmit.

Për nder të kujtimit të dëshmorëve, çdo vit në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit, krerët më të lartë të shtetit, veteranë, familjarë dhe qytetarë të thjeshtë zhvillojnë homazhe dhe ceremoni përkujtimore. Monumenti “Nënë Shqipëri” në Tiranë qëndron si një simbol i përherëshëm i respektit dhe mirënjohjes për ata që sakrifkuan gjithçka për atdheun.

Pas Shpalljes së Pavarësisë më 1912, deri në vitin 1945, shteti shqiptar ende nuk kishte një status ligjor të përcaktuar për dëshmorët e Atdheut. Ishte gjatë Luftës Nacionalçlirimtare që nisën përpjekjet e para për të institucionalizuar nderimin ndaj dëshmorëve. Këto përpjekje u konkretizuan më 28 gusht 1945, me miratimin e ligjit Nr. 109 nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili siguronte shpërblime dhe trajtim për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të



luftës. Ky ligj ishte ndër të parët që përfshinte edhe dëshmorët e periudhave të mëparshme historike, si ata të Rilindjes Kombëtare dhe të luftërave për pavarësi.

Në vitet '60, statusi i dëshmorit u përpunua më tej dhe u zyrtarizua termi “Dëshmor i Atdheut”, duke përfshirë edhe ndërtimin e Varrezave të Dëshmorëve në çdo rreth të vendit. Në këtë periudhë u ngritën edhe struktura të posaçme për ruajtjen e kujtesës historike, monumente dhe muze që i kushtohen Luftës Nacionalçlirimtare dhe dëshmorëve të saj. Pas ndërrimit të sistemit politik në Shqipëri në vitet 1992-1993, statusi i dëshmorit pësoi ndryshime, duke reflektuar realitetin e ri politik dhe pluralizmin e mendimeve për periudhat historike. U rishikuan kriteret për dhënie të këtij titulli dhe u vendos që të

përfshihen edhe ata që kishin dhënë jetën në shërbim të vendit në rrethana të tjera.

Pas shumë diskutimesh dhe përpjekjesh, më 27 prill 2000, u miratua ligji Nr. 8607 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, i cili për herë të parë përfshiu dëshmorët e të gjitha periudhave historike, përfshirë edhe ata që ranë gjatë trazirave të vitit 1997 dhe ata që dhanë jetën në Luftën Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998-1999. Ky ligj shënon një përpjekje për ta trajtuar çështjen e dëshmorëve në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe pa dallime ideologjike apo politike. Kjo ditë është më shumë se një përkujtim, është një thirrje për reflektim dhe përgjegjësi. Sakrifika e dëshmorëve na obligon të punojmë për një Shqipëri më të drejtë, më të bashkuar dhe më dinjitoze për çdo qytetar të saj.


75 Vjetori i Deklaratës së Schumanit: Lindja e Bashkimit Evropian

Më 9 maj 1950, Ministri i Jashtëm Francez i atëhershëm, Robert Schuman, paraqiti një plan për bashkëpunim më të thellë në Evropë. Ky do të bëhej themeli për projektin e integritimit evropian. Fjalimi i tij atë ditë, i njohur si Deklarata e Schumanit, tani konsiderohet gjerësisht si ditëlindja e Bashkimit Evropian. Kjo është arsyeja pse ne festojmë Ditën e Evropës sot.

Në vitin 1950, vendet evropiane ende po rikuperoheshin nga shkatërrimi njerëzor dhe ekonomik i Luftës së Dytë Botërore. Një grup politikanësh evropianë, të vendosur të mos përsërisnin gabimet e së kaluarës, ndanin një vizion për një Evropë të bashkuar që do të parandalonte konflikte të mëtejshme midis vendeve evropiane. Plani i Schumanit hapi rrugën për ta bërë këtë vizion realitet.

